



Ecole Française Internationale de Tirana *Shkolla Franceze Nderkombetare e Tiranës*

RREGULLORJA E SHKOLLËS

Kjo rregullore shërben për të siguruar funksionimin e mirë të shkollës dhe sigurinë e nxënësve e të personelit. Shkolla është një vend kushtuar vetëm për arsimin dhe mësimdhënien.

Kjo rregullore është hartuar për të zbatuar në kushtet më të mira të mësuarit e jetës në komunitet, ndjenjën e përgjegjësisë, të drejtat dhe detyrat e secilit prej aktorëve në komunitetin e shkollës.

Ajo është e bazuar në parimet e mëposhtme :

- 1 . Respektin për të tjerët
- 2 . Mbrojtjen e garantuar kundër çdo abuzimi fizik ose mendor dhe detyrën secilit për të mos përdorur dhunë dhe për të dënuar përdorimin e saj .
- 3 . Detyrimin e nxënësve për të marrë pjesë në të gjitha aktivitetet e parashikuara në program dhe kurikulat zyrtare.
- 4 . Respektimin e orareve Hyrje/Daljeve
- 5 . Mirëmbajtjen e pajisjeve dhe materialeve të vëna në dispozicionin e të gjithëve.

I. Organizimi i vitit shkollor

a) Kalendarit Shkollor

Kalendarit shkollor përpunohet çdo vit. Ai miratohet nga: Shërbimet Kulturore Franceze të Tiranës ,Inspektori i Arsimit Kombëtare Franceze (Romë).

Disa rregullime mund të bëhen për të marrë parasysh disa ditë përkujtimi kombëtare të vendit pritës.

b) Oraret e Shkollës Franceze të Tiranës

Oraret e shkollës fillore , kolegjit CNED (klasa e 6-të , klasa e 5-të) :

Nga ora 8:30 në 12:00 dhe nga ora 13:30 në 15:30 të hënave , të martave , të enjteve dhe të premtëve

Nga ora 8:30 në 12:30 të mërkurave.

c) Pritja e nxënësve

Për nxënësit e kopshtit, pritja bëhet nga mësuesja nga ora 08:20 deri në 08:40. Pas mësimit, nxënësit shoqërohen në taksi.

Për nxënësit nga CP tek CM2 dhe të kolegjit, pritja bëhet në oborrin e shkollës prej orës 08:20 deri në 08:30. Pas mësimit, nxënësit shoqërohen në taksi.

Të mërkurën pas mësimit fëmijët i dorëzohen një të rrituri, shërbimit të shkollës, ose shoqërohen në taksi. Është e domosdoshme që të respektohen këto orare.

Nëse një nxënës duhet të largohet nga shkolla gjatë orëve të mësimit, ai mund ta bëjë këtë vetëm nëse ka një autorizim të nënshkruar. Një nxënës nuk mund të dalë nga shkolla i vetëm gjatë orëve të mësimit.

d) Komunikimi ndërmjet prindërve dhe mësuesve

Mësuesit e EFIT dhe drejtoresha janë në dispozicion të prindërve që dëshirojnë të kenë një takim pas mësimit.



Ecole Française Internationale de Tirana

Shkolla Franceze Nderkombetare e Tiranës

Një mbledhje e fillimit të vitit shkollor u mbajt 15 ditëshin e parë të shtatorit.

Këshilli i shkollës mbledhet çdo semestër. Një raport i mbledhjes i dërgohet të gjitha familjeve, postit diplomatik dhe IEN.

Në çdo klasë nxënësit kanë një fletore ndërlidhëse. Sigurohuni ta kontrolloni rregullisht dhe të konsultoni çdo informacion që ju kalon nëpërmjet saj.

Mund të kontaktoni gjithashtu me e-mail në këto adresa: për kopshtin : ajacquet@efit.edu.al, për ciklin 2: sziko@efit.edu.al, për ciklin 3 dhe drejtorinë: mdebiolles@efit.edu.al, për kolegjin: greynaudall@efit.edu.al dhe fgojka@efit.edu.al, për çështjet administrative: msula@efit.edu.al, për këshillin e shkollës: conseil@efit.edu.al, për zyrën e Shoqatës: info@efit.edu.al .

d) Vlerësimi i aftësive

Nxënësit vlerësohen në lidhje me aftësitë disiplinore dhe atë që dinë të bëjnë. Një librezë shkollore që përmbledh vlerësimet e çdo cikli plotësohet në fund të çdo semestri.

Kjo librezë përdoret për të gjitha ciklet. Ajo i jepet familjeve për nënshkrim pas çdo vlerësimi semestral ose përfundimtar dhe pastaj duhet patjetër t'i kthehet shkollës dhe t'i bashkëngjitet dosjes shkollore.

II . Jeta shkollore

Gjatë orëve të mësimi, fëmijët janë nën përgjegjësinë e mësuesve.

a) Pjesëmarrja

Arsyet e mungesave duhet të jenë vetëm shëndetësore ose familjare. Prindërit duhet të njoftojnë shkollën për çdo rast. Çdo mungesë është e justifikuar.

b) Materiali

Fëmijët dhe prindërit e tyre duhet të tregojnë kujdesin e duhur për mirëmbajtjen e librave dhe fletoreve. Librat dhe fletoret duhet të mbështillen. Një libër i humbur apo i dëmtuar duhet të rimburohet ose të zëvendësohet.

Kutia e mjeteve shkollore duhet të ndërrohet në rast dëmtimi.

Nuk sugjerohen bizhuteritë dhe përgjithsisht çdo objekt me vlerë, lojërat elektronike. Shkolla nuk mban përgjegjësi për humbjen, vjedhjen apo dëmtimin e tyre.

Telefonat celularë do të lihen në zyrën e administrimit dhe mund të merren pas mësimi.

c) Ushqimi në shkollë

Dreka shërbehet e ngrohtë në mensën e shkollës nga kompania e kateringut SAGITAL.

Gjatë pushimit të mëngjesit, fëmijët mund të marrin me vete diçka të lehtë për të ngrënë (fruta, perime ...)

d) Higjiena dhe Siguria

Hyrjet dhe daljet (nga klasa) bëhen në qetësi dhe në rresht.

Asnjë student nuk mund të qëndrojë në klasë pa praninë e një të rrituri.

Gjatë pushimit nuk lejohen dhuna, shtyrjet dhe lojërat e dhunshme.

Është e ndaluar të sjellësh në shkollë ndonjë objekt apo produkt që mund të jetë i rrezikshëm.



Ecole Française Internationale de Tirana *Shkolla Franceze Nderkombetare e Tiranës*

Prindërit janë përgjegjës për materialin që nxënësit sjellin në shkollë dhe ky material duhet të kufizohet vetëm për nevojat e shkollës.

Veshjet duhet të jenë të rregullta dhe në përputhje me kërkesat praktike të shkollës (nuk lejohen shapkat me gisht që nuk mbajnë kyçin e këmbës).

Sigurimi individual i nxënësit është i detyrueshëm.

Në rast aksidenti ose sëmundjeje, prindërit njoftohen menjëherë me telefon .

Asnjë mjekim nuk mund të jepet në shkollë, me përjashtim kur është nënshkruar Projekti i Pritjes Individuale (PAI) .

Karamelet dhe çamçakëzi janë të ndaluara në shkolla.

Nëse një fëmijë ka sëmundje ngjitëse ose morra, prindërit duhet të informojnë menjëherë shkollën.

III . Shpërndarja e rregullores

Kjo rregullore do të miratohet nga Këshilli i Shkollës trimestrin e parë. Pastaj do t'i shpërndahet çdo familjeje dhe stafit të Shkollës Franceze Ndërkombëtare të Tiranës.

Prindërit kanë një rol aktiv në zbatimin e kësaj rregulloreje, duke i nxitur fëmijët e tyre të respektojnë me përpikëri kërkesat dhe punën e shkollës, faktorë të suksesit shkollor. Kjo rregullore do të lexohet dhe diskutohet në klasë.

Nënshkrimi:

nxënësit

prindërit

mësuesit